



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 35

Tiranë – E premte, 3 mars 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 104, datë 1.3.2023	Për kalimin në pronësi të shtetit dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të objektit “Atrium Center Thumana”, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë.. 3399
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 1.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rijetëzimi i siteve dhe i monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga tërmeti në Shqipëri, brenda kufirit të zonës arkeologjike “B”, të qytetit të Durrësit”..... 3399
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 1.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës”..... 3401
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 1.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion ‘Rruga e Korpusit’, Bashkia Shkodër”..... 3403
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 1.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim argjiture mbrojtëse nga lumi Shkumbin në Krastë, në kuadër të projektit ‘Lungo Fiume’, Elbasan”..... 3405
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 1.3.2023	Për hapjen e misionit diplomatik të Republikës së Shqipërisë në Azerbajxhan..... 3407
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 1.3.2023	Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2023..... 3407
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 1.3.2023	Për miratimin e marrëveshjes me shkëmbim notash për grantin për mbështetje buxhetore, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite..... 3409

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 1.3.2023	Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit financiar nga punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh.....	3410
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 119, datë 1.3.2023	Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit.....	3411
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 120, datë 1.3.2023	Për përjashtimin nga ndalimi i gjuetisë, për qëllime shkencore pasvaksinale, të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2020, “Kontrolli dhe çrrënjësja e sëmundjes së tërbimit-faza IV”.....	3414
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 121, datë 1.3.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 325, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e anëtarëve të komisionit të përzgjedhjes së projekteve në turizëm”.....	3416
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 1.3.2023	Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë e Zhvillimin Rural, për vitin 2023.....	3416
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 2.3.2023	Për shpallje ditë zie kombëtare.....	3421



VENDIM
Nr. 104, datë 1.3.2023

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË SHTETIT DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT TË OBJEKTIT “ATRIUM CENTER THUMANA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUIË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit

dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të shtetit dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të objektit “Atrium Center Thumana”, Njësia Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, sipas tabelës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

TË DHËNAT E PËRMBLEDHURA PËR OBJEKTIN “ATRIUM CENTER THUMANA”
(TABELA E INVENTARIT)

r.	arku	Q	B	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi	Ti pollogia e ndërhyrjes	Fina ncini i ndërtimit	Sip ërfate (m²)	Vi era e projekt- idesë	Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e mbikëqyrës	Vler a e kolaudimit	Vlera totale e objektit
	Durrës	ruajt	K	Thumanë	Objekt shumëfunksional	Thumana "Atrium Center"	Ndërtim	Buxhet GoA	2,071.0	-	220,079,942.00	1,695,073.00	70,123.00	221,845,138.00
TOTAL									2,071.0	-	220,079,942.0	1,695,073.0	70,123.0	221,845,138.0

VENDIM
Nr. 106, datë 1.3.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIJETËZIMI I SITEVE DHE I MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË PREKURA NGA TËRMETI NË SHQIPËRI, BRENDA KUFIRIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “B”, TË QYTETIT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rijetëzimi i siteve dhe i monumenteve të trashëgimisë kulturore të prekura nga tërmeti në Shqipëri, brenda kufirit të zonës arkeologjike “B”, të qytetit të Durrësit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Qendrës Muzeore Durrës, Ministria e Kulturës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 28 892 636 (njëzet e tetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 28 892 636 (njëzet e tetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Kulturës.



5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Ministria e Kulturës.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Ministrisë së Kulturës.

8. Ministria e Kulturës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Ministria e Kulturës.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të

miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Qendrës Muzeore Durrës, Ministria e Kulturës, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Qendrës Muzeore Durrës, Ministria e Kulturës, të pasurive që shpronësohen, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Qendra Muzeore Durrës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONAREVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIJETËZIMI I SITEVE DHE MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË PREKURA NGA TËRMETI NË SHQIPËRI, BRENDË KUFIRIT TË ZONËS ARKEOLOGJIKE “B” TË QYTETIT TË DËRRËSIT”

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE											TRUALL			VLERA TOTALE (€)	SHËNIME (Kufiri hipotekar, llogarit në pasuritë etj.)
	Emri	Aktiva	Mbështet	Pasuri me qytet	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Llogarit pasurisë	Shprehja e toke	Akt (m²)	Truall (m²)	Natyrë (m²)	Volumi	Pesë	Shprehja (m²)	Qantari (t/m²)	Vlera (€)			
	A	B	C	C	C	D	E	F	G	H	I	J	K	O	P	Q	Y	Z	
1	Trashëgimia e familjes Dvorca			DURRËS	8512	25/171	TRUALL	2580		2580		31	72	1104.36	19155	21154016	21154016	Data e regjistrimit: 15.5.2004 - Prima kaluarit për plotësim dokumentacion me udhëz të regjistrimit nr. 5, datë 9.1.2004. Ka 5 udhëzime, pa llogarit: NPL1=220.00 m², NPL2=90.72 m², NPL3=70.28 m², NPL4=109.20 m², NPL5=28.18 m². Ka mbështetje me pasuritë: 25/26 (vol.31, l. 79), 25/147 (vol. 28, l. 48), 25/146 (vol. 26, l. 49), 25/31 (vol. 28, l. 51). Data e regjistrimit 20.1.2007 - Kufirithe prona deri në përfundimin e procedurës së licitimit për fshirje të pronës. Në bazë të v. 10, datë 15.1.1991 (shprehja vendosur parafundimisht) nr. 5, datë 20.1.1991 të EVKPP deri në përfundimin e procedurës për të 511 të vitit 2009 për sip. 26.4 m². Konfirmuar nga ASHIN-ja.	
2	Agim Sofie Mirre Rikard Gjergjina Linda Rikarda Rikardina Mirre Linda	Kol Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha	Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha Berisha	DURRËS	8512	25/130	TRUALL	404		404		18	18	404.0	19155	7738620	7738620	Konfirmuar nga ASHIN-ja.	
VLERA TOTALE																	28 992 636		

**VENDIM****Nr. 107, datë 1.3.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT
“RESTAURIMI DHE RIKUALIFIKIMI
URBAN I ZONËS PERSPEKTIVE TID,
ME VENDNDODHJE NË PARKUN
ARKEOLOGJIK DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Kulturës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 89 163 005.10 (tetëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesë pikë dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 89 163 005.10 (tetëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesë pikë dhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Kulturës.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Ministrisë së Kulturës.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Ministrisë së Kulturës.

8. Ministria e Kulturës kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Ministria e Kulturës.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Durrës pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës, të pasurive që shpronësohen, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

Page | 3402



VENDIM
Nr. 108, datë 1.3.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION
‘RRUGA E KORPUSIT’, BASHKIA
SHKODËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruktion ‘Rruga e Korpusit’, Bashkia Shkodër”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Shkodër.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 8 116 072 (tetë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e dy) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 8 116 072 (tetë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e dy) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (muajve) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Shkodër.

8. Bashkia Shkodër kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Shkodër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Shkodër.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Shkodër për pasurinë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILËVE PREKET
NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “RIKONSTRUKSION ‘RRUGA E KORPUSIT’ BASHKIA SHKODËR”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			VLERA TOTALE (lekë)	SHËNIME (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qytei	Z. kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	Ç	D	F		G	H	I	J	K	L	M	N	O
1	Adriana	Halim	Demaliaj (Dumi)	Shkodër	8592	9/482	TRUALL	3156	3156	22	245	664	12223	8 116 072	8 116 072	Konfirmuar nga ASHK Vendore Shkodër sipas pjesëve takuese në vërtetimin hipotekor 1. Adriana Halim Demaliaj (Dumi) ka 36/864 pjesë, me vlerë 338169.97 lekë
	Anila	Tonin	Mjeda													2. Anila Tonin Mjeda ka 72/864 pjesë me vlerë 676339.33.
	Apolonja	Çezar	Mjeda													3. Apolonja Çezar Mjeda ka 120/864 pjesë me vlerë 1127232.22 lekë
	Arben	Halim	Dumi													4. Arben Halim Dumi ka 36/864 pjesë me vlerë 338169.97 leke
	Brikena	Çezar	Mjeda													5. Brikena Çezar Mjeda ka 120/864 pjesë me vlerë 1127232.22 lekë
	Cecile	Baldazar	Mjeda													6. Cecile Baldazar Mjeda ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë
	Eduard	Sander	Kraja													7. Eduard Sander Kraja ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë
	Fatime	Halim	Dumi													8. Fatime Halim Dumi ka 36/864 pjesë me vlerë 338169.97 lekë .
	Leonard	Sandër	Kraja													9. Leonard Sandër Kraja ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë
	Ludmilla	Halim	Papa (Dumi)													10. Ludmilla Halim Papa (Dumi) ka 36/864 pjesë me vlerë 338169.97 lekë
	Mariza	Ndoc	Mjeda													11. Mariza Ndoc Mjeda ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 leke.
	Meri	Sandër	Kraja													12. Meri Snder Kraja ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë
	Niko	Pashko	Mjeda													13. Niko Pashko Mjeda ka 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë
	Rozina	Pashko	Mjeda													14. Rozina Pashko Mjeda 48/864 pjesë me vlerë 450892.88 leke.
	Silvana	Tonin	Mjeda													15. Silvana Tonin Mjeda ka 72/864 pjesë me vlerë 450892.88 lekë
							Vlera totale								8 116 072	



VENDIM
Nr. 109, datë 1.3.2023

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM
ARGJINATURE MBROJTËSE NGA LUMI
SHKUMBIN NË KRASTË, NË KUADËR
TË PROJEKTIT ‘LUNGO FIUME’,
ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim argjinature mbrojtëse nga lumi Shkumbin, në Krastë, në kuadër të projektit “*Lungo Fiume*”, Elbasan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “pyll”, me një vlerë të përgjithshme prej 161 829 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekësh.

4. Masa e shpërblimit për pronarët që shpronësohen, prej 161 829 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekësh, përballohet nga Bashkia Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe afati i

përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Elbasan, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Elbasan pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Elbasan, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA E PRONARËVE QE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIM ARGJINATURE MBROJTËSE NGA LUMI ‘SHKUMBIN’ NË KRASTË, NË KUADËR TË PROJEKTTIT ‘LUNGO FIUME’, ELBASAN’

NR.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM												SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekare, hartë mbi pasuritë etj.)		
													"ARË"			"KULLOTË"			"PYLL"			Vlerat e kulturës bujqësore dhe drimorë sipas proces-verbali të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (tëqë)			
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose Qyteti	Zona Kadastrale	Nr. pasuritë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Aq" (m2)	"Kullotë" (m2)	"Pyll" (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Gjini (tëqë/m2)	Vlera (tëqë)	Sipërfaqja(m2)	Gjini (tëqë/m2)	Vlera (tëqë)	Sipërfaqja(m2)	Gjini (tëqë/m2)	Vlera (tëqë)	Vlera e kulturës bujqësore (tëqë)			Vlera e drimorë (tëqë)	
	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	X	Y	Z		
1	SUZANA	XHAVIT	MALIQI	HAJDARAN ELBASAN	1909	15/6/1	PYLL	9687	0	0	9687		0	0	0	0	0	0	423	85	35955	0	0	35955	Konfirmuar nga ASHDK		
	NEVREZ	XHAVIT	GJYLBEGU																								
2	REFAT	MET	QEFALIA	SHUSHICË ELBASAN	3445	218/1	ARË	4200	4200	0	0		258	222	57276	0	0	0	0	0	0	0	0	57276	Konfirmuar nga ASHDK		
3	MEHMET	ZENEL	QEFALIA	SHUSHICË ELBASAN	3445	218/4	ARË	7740	7740	0	0		309	222	68598	0	0	0	0	0	0	0	0	68598	Konfirmuar nga ASHDK		
SHUMA TOTALE																										103629	

**VENDIM****Nr. 110, datë 1.3.2023****PËR HAPJEN E MISIONIT
DIPLOMATIK TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË AZERBAJXHAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e misionit diplomatik “Ambasadë” të Republikës së Shqipërisë në kryeqytetin e Azerbajxhanit, Baku.

2. Shpenzimet për hapjen e këtij misioni diplomatik do të përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për vitin 2023.

3. Ngarkohet Ministria e për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

VENDIM**Nr. 111, datë 1.3.2023****PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË
AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS, PËR
VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2023, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2023.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



SHTOJCA NR. 1
PEMA E PROGRAMIT TË ASHK-së, PËR VITIN 2023

II



SHTOJCA NR. 2
BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS 2023
000/lekë

PËRSHKRIMI	Buxheti Janar- Dhjetor 2023	
	Të Ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga Shërbimet +Parcela ndërtimore+Të tjera	5.280.066	
Te ardhura nga buxheti i shtetit	521.108	
Shpenzime personeli		2.449.833
Shpenzime korente		561.272
Shpenzime kapitale nga e cila:		2.569.425
Për projektin e Qendrës së Kadastrës Dixhitale		521.108
Fondi rezervë		104.700
Total ASHK	5.801.174	5.685.230
Të ardhura të pashpërndara ASHK (Te ardhura - Shpenzime)		115.944



SHTOJCA NR. 3
BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS 2023

000/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Planifikim 2023
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	5.801.174
1	Të ardhura nga shërbimet	1.800.000
2	Të ardhura nga transferimi I parcelës ndërtimore	300.000
3	Të ardhura të tjera	280.000
4	Fonde që trashëgoohen nga viti 2022	2.900.066
5	Fonde te transferuara nga buxheti I shtetit	521.108
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	5.685.230
1	Shpenzime personeli	2.449.833
1	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të propozuar	1.435.580
2	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit në organikë	239.347
3	Paga për punonjësit me kontratë të propozuar	602.508
4	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit me kontratë	100.619
5	Fondi i vecantë i pagave	71.779
2	Shpenzime operative	561.272
1	Shpenzime për mallra dhe shërbime	561.272
3	Shpenzime Kapitale	2.569.425
a	Shpenzime kapitale për projektin e Qendrës së Kadastrës Dixhitale	521.108
b	Investime kapitale të patrupëzuara	718.398
1	Regjistrim Fillestar për 15 ZK	75.000
2	Shpenzime për investime të patrupëzuara	643.398
c	Investime kapitale të trupëzuara(Rikonstruktion +Infrastrukture IT)	1.329.919
1	Rikonstrukcione (Drejtorite Vendore te ASHK-se Tirane+Vlore+Kukës etj)	826.605
2	Infrastrukture e sistemeve te IT+ blerje paisje	448.313
3	Orendi	55.000
4	Fondi Rezervë	104.700
1	Fondi Rezervë	104.700
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME(te ardhura te pashpermdara)	115.944

VENDIM

Nr. 112, datë 1.3.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
ME SHKËMBIM NOTASH PËR
GRANTIN PËR MBËSHTETJE
BUXHETORE, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË
ARABISË SAUDITE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes me shkëmbim notash për grantin për mbështetje buxhetore,

ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË
MINISTRI**

**Drejtuar: Ambasadës Mbretërore
të Arabisë Saudite në Tiranë**

Projekti: Dhurim në formë mbështetjeje buxhetore për qeverinë shqiptare

I nderuar z. Ambasador,

Në vijim të notës verbale nr. 415-44-422, datë 7.11.2022 të Ambasadës Mbretërore të Arabisë



Saudite në Tiranë, lidhur me grantin në vlerë 50 milionë dollarë amerikanë në formë mbështetjeje buxhetore nga Mbretëria e Arabisë Saudite për qeverinë shqiptare, për përballimin e krizës energjetike globale dhe duke konsideruar marrëdhëniet e ngushta të miqësisë ndërmjet dy shteteve tona.

Në vijim të dakordësisë së arritur me Mbretërinë e Arabisë Saudite lidhur me vlerën e grantit prej 50 milionë dollarësh amerikanë në formë mbështetjeje buxhetore, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë shprehet dakord për pranimin e premtimit financiar të sipërcituar.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi, pasi palët të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme.

Me respekt

Ministri i Financave dhe Ekonomisë

**AMBASADA E MBRETËRISË
SË ARABISË SAUDITE
TIRANË**

(Urgjent)

Prot. 415-44-422

Datë 7.11.2022

Ambasada e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë i shpreh komplimentet e saj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë.

Dhe ka nderin të informojë se Mbretëria e Arabisë Saudite ndjek nga afër zhvillimet ekonomike në vendet e saj aleate dhe sa herë që çmohet e nevojshme dhe e arsyeshme, ofron ndihmë financiare për të mbështetur zhvillimin e tyre.

Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ngushta midis dy vendeve tona ndër vite, si dhe situatën aktuale ekonomike në Shqipëri, të dobësuar më tej nga kriza globale energjetike dhe presionet inflacioniste, Mbretëria e Arabisë Saudite bie dakord t'i japë qeverisë shqiptare një shumë prej 50 milionë \$ (pesëdhjetë milionë dollarë)

Ky grant i pashlyeshëm vjen në formën e mbështetjes buxhetore për t'u disbursuar në një transh, pa parakushte dhe për t'u përdorur me diskrecionin e qeverisë shqiptare.

Ambasada pret marrjen e informacionit nga ana juaj mbi modalitetet e disbursimit.

Ambasada e Mbretërisë së Arabisë Saudite përfiton nga rasti për t'i shprehur edhe një herë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë konsideratën e saj më të lartë.

Vula Nënshkrimi

VENDIM

Nr. 117, datë 1.3.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE,
TË DOKUMENTACIONIT DHE TË
MASËS SË PËRFITIMIT FINANCIAR
NGA PUNONJËSIT DHE ISH-
PUNONJËSIT E RAFINERISË SË
NAFTËS, BALLSH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Dhënie pagese kalimtare, në masën e pagesë minimale në shkallë vendi, për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh, pas verifikimit nga zyra përkatëse e punësimit të listës emërore, sipas vendimit nr. 909, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh", të ndryshuar, për çdo muaj, për periudhën janar–qershor 2023.

2. Punonjësve, sipas pikës 1, të këtij kreu, t'u paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për pjesën e punëmarrësit e të punëdhënësit, për periudhën janar–qershor 2023, duke iu transferuar fondi përkatës Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

**II. KRITERET DHE
DOKUMENTACIONI PËR PËRFTITIMIN E
NDIHMËS FINANCIARE**

1. Pagesa kalimtare për punonjësit, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, jepet çdo muaj, për



periudhën janar – qershor 2023, pranë zyrës së punësimit, ku kanë vendbanimin.

2. Pagesa kalimtare përfitohet nga punonjësit, sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, pavarësisht nëse kanë përfituar apo jo më parë ndihmë financiare.

3. Pagesa kalimtare u jepet punonjësve, sipas listës së miratuar me vendimin nr. 909, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për punonjësit dhe ish-punonjësit e rafinerisë së naftës, Ballsh”, të ndryshuar, pas verifikimeve nga zyra përkatëse e punësimit, duke përjashtuar nga përfitimi personat që:

- a) janë të punësuar apo të vetëpunësuar;
- b) kanë dalë në pension pleqërie apo invaliditeti të plotë;
- c) nuk janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

4. Punonjësit kërkues duhet të paraqesin pranë zyrës përkatëse të punësimit të dhënat e mëposhtme identifikuese, si:

- a) emrin, mbiemrin;
- b) numrin personal të identifikimit;
- c) llogarinë bankare, në bankën me të cilën ka marrëveshje zyra e punësimit;
- ç) IBAN-in e llogarisë bankare.

III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Zyra përkatëse e punësimit, brenda 5 (pesë) ditëve të para pune nga data e kërkesës, bën verifikimet përkatëse në sistemin tatimor mbi të dhënat e deklaruara nga kërkuesit.

2. Zyra përkatëse e punësimit, brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji, gjatë periudhës së përfitimit, bën verifikimet, sipas pikës 1, të këtij kreu, përpilon listat përmbledhëse të përfituesve, të ndara për çdo bankë të nivelit të dytë, ku përfituesit kanë llogarinë rrjedhëse bankare, të cilat i dërgon pranë bankës së nivelit të dytë. Lista duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme, si:

- a) emrin, mbiemrin e përfituesit;
- b) numrin personal të identifikimit të përfituesit;
- c) bankën ku ka marrëveshjen zyra përkatëse e punësimit;
- ç) IBAN-in e llogarisë bankare;
- d) masën e pagesës.

3. Zyra përkatëse e punësimit ruan dhe administron dokumentacionin e përcaktuar sipas këtij vendimi, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore të parashikuara për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivat.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Fondi prej 142 000 000 (njëqind e dyzet e dy milionë) lekësh përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2023 për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht, në zërin “Pagesa e papunësisë”, të programit buxhetor 10550 “Tregu i punës”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM Nr. 119, datë 1.3.2023

PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 5, dhe 37, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:

- a) punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare publike (në vijim IAP publike), ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator, oficerë sigurie, punonjës të shërbimit psiko-social), që punojnë larg vendbanimit të përhershëm të tyre, jashtë qendrave urbane dhe kthehen brenda ditës në vendbanim, në distancën mbi 5 km deri në 50 km;



b) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg IAP-ve publike më të afërta (shkollë/kopsht);

c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale, të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në IAP-të publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);

ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara, që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik;

d) nxënësve që ndjekin procesin mësimor në IAP-të publike, të arsimit të mesëm të lartë dhe të arsimit profesional, godinat e të cilave kanë dalë jashtë funksionit apo janë në rikonstruktion/rindërtim, vërtetuar me aktet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe që udhëtojnë mbi 5 km për të ndjekur procesin mësimor, larg vendbanimit të përhershëm;

dh) nxënësve që ndjekin arsimin profesional publik, që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 5 km deri në 50 km larg ofruesit publik të arsimit profesional.

Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë IAP-të publike (shkollë/kopsht).

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktojnë linjat përkatëse në pjesë të rrjetit të linjave të transportit rrethqytetas, të miratuara nga këto njësi, mbështetur në numrin e fëmijëve/nxënësve dhe të punonjësve arsimorë të IAP-ve publike, që planifikohen të përfitojnë nga ky shërbim, sipas kritereve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, bazuar në informacionin që marrin nga zyrtarë vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) dhe ofruesit e arsimit profesional publik, brenda muajit tetor për vitin e ardhshëm buxhetor. Listat e përfituesve konfirmohen nga ZVAP-të dhe ofruesit e arsimit profesional publik pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për distancën nga vendbanimi i përhershëm dhe dërgohen në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe ofruesit e arsimit profesional publik, për të realizuar procedurën e prokurimit publik,

brenda muajit nëntor, për vitin e ardhshëm buxhetor.

3. DRAP-të dhe ofruesit e arsimit profesional publik prokurojnë me fonde publike shërbimin e transportit të nxënësve dhe të punonjësve arsimorë, sipas linjave në përbërje/pjesë të rrjetit të linjave të transportit rrethqytetas, të miratuara nga këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Përlllogaritja e fondeve, që prokurohen, kryhet mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të mësuesve që përfitojnë shërbim transporti, vetëm për ata punonjës arsimorë që udhëtojnë brenda linjave të transportit rrethqytetas, numrit të nxënësve që përfitojnë shërbimin e transportit dhe çmimit të indeksuar me normën e inflacionit të tarifës/çmimit të biletës për linjat rrethqytetase të transportit, të cilat, bazuar në shkronjën “ç”, të nenit 10, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, miratohen me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore, duke shtuar, vetëm për nxënësit, edhe 50 (pesëdhjetë) për qind mbi çmimin e indeksuar të vlerës së biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

4. Në rastet kur procedura e prokurimit publik të linjave të transportit rrethqytetas, të parashikuara në pikën 3, të këtij vendimi, nuk realizohet me sukses nga DRAP-ja, me autorizimin e kësaj të fundit, ZVAP-ja siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë të IAP-së publike përfitues, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, të kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve arsimorë të IAP-së publike, përfitues ose nëpërmjet shërbimit postar, vetëm për ato zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 2, të këtij vendimi, deri në përfundim të vitit buxhetor.

Në arsimin profesional, në rastet kur ofruesi i arsimit profesional publik nuk realizon me sukses procedurën e prokurimit publik të linjave të transportit rrethqytetas, vetë ofruesi i arsimit profesional siguron mbulimin e shpenzimeve për linjat e transportit të nxënësve dhe punonjësve arsimorë përfitues, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë të prindërve të nxënësve, të kujdestarëve ligjorë apo të përfituesve me prokurë të posaçme dhe të punonjësve arsimorë.



Masa e shpenzimeve nga ZVAP-të llogaritet vetëm mbi bazën e numrit të ditëve mësimore të realizuara, numrit të punonjësve arsimorë që janë paraqitur në punë, numrit të nxënësve që kanë ndjekur mësimin dhe çmimit të biletës, të miratuar me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, i cili indeksohet me normën vjetore të inflacionit, duke shtuar, vetëm për nxënësit, edhe 50 (pesëdhjetë) për qind mbi çmimin e indeksuar të vlerës së biletës, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

5. Punonjësve arsimorë, të cilët janë të punësuar në IAP-të publike, jashtë territorit të bashkisë së vendbanimit të tyre, në distancat, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, u paguhet çmimi i indeksuar me normën e inflacionit të tarifës së biletës të linjave në përbërje/pjesë të rrjetit të linjave të transportit ndërqytetës, miratuar nga ministri përgjegjës për transportin, në masën e përcaktuar në vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, në përputhje me numrin e ditëve që janë paraqitur në punë, të konfirmuara nga drejtori i institucionit arsimor. Pagesa për këtë kategori punonjësish kryhet në llogaritë e tyre bankare dhe kjo kategori punonjësish nuk përfshihet në përlogaritjen e fondit, sipas pikës 3, të këtij vendimi.

6. Punonjësit arsimorë, që përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit të siguruar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë kompensim mujor të diferencuar, sipas paragrafit 4.a), të pikës 4, të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar, për distancat, si më poshtë vijon:

a) në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm i tyre, deri në institucionin arsimor publik parauniversitar është në distancën mbi 5 km deri në 10 km;

b) në masën 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm, deri në institucionin arsimor publik parauniversitar është në distancën mbi 10 km deri në 20 km;

c) në masën 2 700 (dy mijë e shtatëqind) lekë në muaj, kur largësia nga vendbanimi i përhershëm,

deri në institucionin arsimor publik parauniversitar është në distancën mbi 20 km deri në 50 km.

ZVAP-et dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë dhe koordinojnë të dhënat për numrin e përfituesve e largësitë nga vendbanimi dhe raportojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, çdo 3 (tre) muaj.

7. Punonjësit arsimorë, të cilët janë punësuar në IAP-të publike, në distancë nga vendbanimi mbi 50 km dhe nuk përfitojnë fonde publike për mbulimin e shpenzimeve të transportit, sipas këtij vendimi, përfitojnë kompensim mujor, sipas paragrafit 4.b), të pikës 4, të vendimit nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.

8. Efektet financiare për arsimin e përgjithshëm, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin, e cila rishpërndan fondet përkatëse të ZVAP-të, si dhe nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në rastet kur me vendim të organeve kolegjiale, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të financojnë shpenzime transporti për nxënësit dhe punonjësit e arsimit parauniversitar publik edhe për distanca të tjera, jashtë përcaktimeve të këtij vendimi. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për nxënësit dhe mësuesit e arsimit profesional publik përballohen nga buxheti i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

9. Vendimi nr. 682, datë 29.7.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar, shfuqizohet.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrtat vendore të arsimit parauniversitar, ofruesit e arsimit profesional publik dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM

Nr. 120, datë 1.3.2023

**PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI I
GJUE TISË, PËR QËLLIME SHKENCORE
PASVAKSINALE, TË KAFSHËVE TË
VAKSINUARA, NË KUADËR TË
PROJEKTIT IPA 2020, “KONTROLLI DHE
ÇRRËNJOSJA E SËMUNDJES SË
TËRBIMIT-FAZA IV”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, shkronja “b”, dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 60/2022, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfshirjen nga ndalimi i gjuetisë, duke lejuar gjuetinë e dhelprës së kuqe, për qëllime shkencore pasvaksinale, në kuadër të projektit IPA 2020, “Kontrolli dhe çrrënjësia e sëmundjes së tërbimit – faza IV”, financuar nga Bashkimi Evropian.

2. Gjuetia e dhelprës së kuqe për marrjen e kampionëve të dhelprës kryhet në të gjithë territorin e vendit, me përjashtim të territorit të zonave të mbrojtura mjedisore, përgjatë muajit mars 2023. Brenda kësaj periudhe, gjuetia të kryhet në ditët e mërkurë, e enjte, e premte dhe e shtunë.

3. Për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, nëpërmjet gjuajtjes së tyre, të angazhohen në të gjithë vendin 39 (tridhjetë e nëntë) punonjës të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të pajisur me shenjë dalluese për këtë proces, për sigurimin në total të 324 (treqind e njëzet e katër) kampionëve të dhelprave të kuqe. Numri i personave, që realizojnë marrjen e kampionëve në çdo qark, si dhe numri i kampionëve të dhelprave që sigurohen për secilin qark, jepen në shtojcën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Detajimi i punonjësve përkatës, që

marrin pjesë në këtë proces, bëhet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Marrja e kampionëve nga dhelprat e kuqe bëhet nga Shërbimi Veterinar, rajoni i zonës përkatëse.

4. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pajis me autorizimin përkatës për marrjen e kampionëve të dhelprës së kuqe për çdo qark, punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, që marrin pjesë në këtë proces.

5. Gjatë gjithë kohës së kryerjes së kësaj veprimtarie në zonat ku do të kryhet vrasja dhe marrja e kampionëve nga dhelprat, procesi kontrollohet nga strukturat vendore përgjegjëse për pyjet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, shërbimet veterinarë përkatëse dhe Policia e Shtetit.

6. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të bashkëpunojë me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura në lidhje me pajisjen e punonjësve të kësaj agjencie me pajisje (*frigobokse*) për ruajtjen e kampionëve (kokat e dhelprave). Punonjësit e Agjencisë Rajonale të Zonave të Mbrojtura pas marrjes së kampionëve (kokat e dhelprave) t'i dorëzojnë këto të fundit pranë shërbimit veterinar rajonal përkatës.

7. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bashkërendon punën për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe raportimin për përfundimin e kësaj faze të procesit të monitorimit pasvaksinal kundër sëmundjes së tërbimit të dhelprës së kuqe në Shqipëri.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku



SHTOJCË
NUMRI I GJUESTARËVE PËR SIGURIMIN E KAMPIONEVE LABORATORIKE
NUMRI I KAMPIONEVE TË DHELPRAVE TË KUQE

Nr.	Qarku	Bashkia	Nr. Punonjësve në qark	Nr. i kampioneve të dhelprave të kuqe	
				Qark	Bashki
1	BERAT		5	21	
		Berat			12
		Kuçovë			2
		Skrapar			3
		Polican			2
		Ura Vajgurore			2
2	DIBËR		3	24	
		Dibër			10
		Bulqizë			7
		Mat			4
		Klos			3
3	DURRËS		3	10	
		Durrës			3
		Shijak			3
		Krujë			4
4	ELBASAN		3	37	
		Elbasan			8
		Belsh			4
		Vërrik			4
		Librazhd			5
		Përrenjas			4
		Peqin			4
		Gramsh			8
5	FIER		4	24	
		Fier			6
		Lushnje			6
		Divjakë			3
		Roskovec			2
		Mallakastër			4
		Patos			3
6	GJIROKASTËR		2	38	
		Gjirokastrë			12
		Libohovë			5
		Tepelenë			6
		Memaliaj			4
		Përmet			7
		Këlcyrë			2
		Dropull			2
7	KORÇË		4	53	
		Korçë			14
		Maliq			5
		Devoll			4
		Pustec			3
		Kolonjë			14
		Pogradec			13
8	KUKËS		1	20	
		Kukës			8
		Tropojë			11
		Has			1
9	LEZHË		5	12	



		Lezhë			3
		Kurbín			3
		Mirditë			6
10	SHKODËR		2	36	
		Shkodër			12
		Vau i Dejës			4
		Malësi e Madhe			14
		Pukë			4
		Fushë-Arrëz			2
11	TIRANË		5	13	
		Tiranë			4
		Vorë			2
		Kamzë			2
		Kavajë			3
		Rrogozhinë			2
12	VLORE		2	36	
		Vlorë			20
		Sarandë			2
		Konispol			2
		Fëniq			4
		Delvinë			4
		Himarë			2
		Selenicë			2
	TOTALI		39	324	

VENDIM**Nr. 121, datë 1.3.2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 325, DATË 31.5.2018, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË
PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE NË
TURIZËM”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 325, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, emërtimet “Drejtori i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Turizmit” dhe “Drejtori i Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Turizmit” zëvendësohen përkatësisht me “Drejtori i Zhvillimit të Programeve të Turizmit” dhe “Drejtori i Projekteve Zhvillimore të Turizmit”.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Komisioni Përzgjedhjes i Projekteve në Turizëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Belinda Balluku****VENDIM****Nr. 125, datë 1.3.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE
BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË
MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË
FINANCIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË E
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, të nenit 13, të ligjit nr. 36/2022, “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimt”, dhe të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Fondi i miratuar në buxhetin e vitit 2023 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (llogaria ekonomike 606), të përdoret për:

a) rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve blegtorale dhe të prodhimeve bujqësore në mjedise të mbrojtura, duke ulur kostot nëpërmjet pagesave për kafshë të matrikulluara, si dhe për sipërfaqe të kultivuar;

b) certifikimin e produkteve bujqësore dhe fermave organike;

c) ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe tregjeve të kafshëve të gjalla në disa bashki të vendit;

ç) përmirësimin e eficiencës energjetike dhe përshtatjen e kapaciteteve të peshkimit me burimet peshkore;

d) mbështetjen me naftë për bujqësinë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore;

dh) mbështetjen për trajnimin dhe transferimin e njohurive në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural.

2. Masat e mbështetjes dhe masa e financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë, si më poshtë vijon:

2.1 Bujqësia, blegtoria dhe peshkimi:

a) Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë lopë, në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt;

b) Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën deri në 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt;

c) Mbarështrim i bletarisë në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt;

ç) Mbështetje për fara/fidanë dhe impute të tjera, në vlerën deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezone, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermerë individualë ose grup fermerësh, me

sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për aplikant;

d) Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) për fermë të certifikuar;

dh) Implementimi dhe certifikimi global GAP, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

i. por jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha;

ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur.

e) Për rinovimin e infrastrukturës së anijes së peshkimit, masa e përfitimit të jetë në 50% e vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 13 500 000 (trembëdhjetë milionë e pesëqind mijë) lekë për anije peshkimi të pajisur me leje të vlefshme peshkimi tregtar dhe jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt. Rinovimi i anijes së peshkimit përfshin:

i. blerjen dhe instalimin e motorit kryesor, por jo më shumë se 7 000 000 (shtatë milionë) lekë;

ii. blerjen dhe instalimin e motorit ndihmës (gjeneratori detar), por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë;

iii. blerjen dhe instalimin e vinçit të anijes, por jo më shumë se 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë. Vinçi përfshin edhe agregatet, hidromotorin, pompë vaji friksion, multiplikator dhe tubacionet;

iv. blerjen dhe instalimin e kamios (koplunit), por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë lekë);

v. riparimin e përgjithshëm të anijes, por jo më shumë se 9 000 000 (nëntë milionë) lekë. Në riparimin e përgjithshëm, përveç zërave të përcaktuar në dokimin periodik, sipas nënndarjes “vi”, përfshihen dhe zëvendësim llamarine ose ndërrim dërrase;



vi. dokimin periodik të anijes, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë. Dokimi periodik përfshin ngritjen dhe uljen nga kantieri, pastrimin dhe heqjen e bojës së vjetër, blerje boje, stuko, protektor (zinqe), riparim aksi helike.

2.2 Tregjet e produkteve bujqësore, tregjet e kafshëve të gjalla dhe thertoret

Mbështetje për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore, tregjeve të kafshëve të gjalla ose thertoreve për shoqëritë tregtare me kapital 100% shtetëror, të zotëruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, në vlerën jo më shumë se 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë për subjekt, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transfertat të brendshme”. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ekzekuton transferimin e fondit përkatës të bashkia përkatëse, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

2.3 Mbështetje me naftë për punimet e mekanizuara

2.3.1 Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, në vlerën deri në 1 328 000 000 (një miliard e treqind e njëzet e tetë milionë) lekë.

2.3.2 Subjektet përfituese mbështeten me sasi naftë falas në barasvlerë të lehtësimit fiskal të naftës, që përdoret për kryerjen e punimeve të mekanizuara në kulturat bujqësore, sipas kritereve dhe masës së përfitimit, të përcaktuara në këtë vendim.

2.3.3 Kulturat bujqësore/grup-kulturat, normativat e konsumit të naftës dhe sasia respektive e naftës, që përfitohet falas, janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Çmimi referencë për naftën llogaritet nga çmimi i publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i Agjencisë së Prokurimit Publik (rubrika “Të dhëna për karburantet), me burim informacioni Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2.3.4 Subjektet përfituese duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Të kenë tokë bujqësore në pronësi dhe/ose në përdorim, të provuar me dokumentacionin përkatës;

b) Madhësia totale e fermës duhet të jetë me sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha, ndërsa madhësia e parcelave me sipërfaqe jo më pak se 0.1 ha.

2.3.5 Aplikimi për të përfituar nga masa e mbështetjes me naftë për bujqësinë, bëhet *online*, në portalin *e-Albania*, me vetëdeklarim.

2.3.6 Përfitimi i sasisë së naftës falas për sipërfaqen që kultivohet është, si më poshtë vijon:

i. 100% e sasisë për subjektet me sipërfaqe deri në 10 ha, sipas përllogaritjeve të bëra, referuar aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ii. subjektet me sipërfaqe mbi 10 ha, për sipërfaqen deri në 10 ha, përfitojnë sasinë, sipas përcaktimit të nënndarjes “i”, të kësaj pike, ndërsa për pjesën tjetër mbi 10 ha përfitojnë sasinë e naftës me normativë të reduktuar. Normativa e reduktuar përllogaritet bazuar në nevojat për naftë të subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha, por jo më shumë se normativa e lejuar, si dhe në sasinë e mbetur të naftës në dispozicion, pasi janë plotësuar nevojat deri në 10 ha të të gjithë subjekteve, që janë kualifikuar si përfitues.

2.3.7 Aplikimet i nënshtrohen procesit të verifikimit/kontrollit administrativ dhe për aplikimet fituese kryhet kontrolli në terren. Procesi i kontrollit në terren kryhet pas shpërndarjes së naftës të subjekteve përfituese:

a) për të vlerësuar përputhshmërinë e vetëdeklarimeve me situatën reale dhe shmangien e lejuar të faktit të verifikuar të kulturave dhe të sipërfaqes së kultivuar, në raport me naftën e tërhequr, e cila të jetë jo më e madhe se 20%;

b) në jo më pak se 10% të subjekteve përfituese, përfshirë kontrollin e gjitha subjekteve me sipërfaqe mbi 10 ha.

2.3.8 Çdo subjekt, që përfiton nga skema e mbështetjes me naftë për bujqësinë, me shmangie më të madhe se 20%, sipas përcaktimeve të pikës 2.3.7, shkronja “a”, ose me deklarime/dokumente të pasakta, përjashtohet për 3 (tre) vjet nga e drejta e përfitimit prej masave mbështetëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, të financuara nga buxheti i shtetit. Subjektet me status fizik dhe juridik shpallen edhe debitor për vlerën e përfituar në mënyrë të padrejtë.

2.3.9 Nafta për bujqësinë do të shpërndahet nga operatorët furnizues të kontraktuar në bazë të përzgjedhjes, sipas procedurave ligjore prokuruese kuadër, nëpërmjet pikave të tyre të shpërndarjes në të gjithë vendin, ku fermerët paraqiten me kartën individuale, në të cilën është hedhur informacioni për sasinë e naftës që ka të drejtë të tërheqë fermeri përkatës. Procedura e prokurimit për blerjen dhe



shpërndarjen e naftës për përdorim nga fermerët realizohet, në përputhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik. Likuidimi i pagesave për furnizuesit e kontraktuar të naftës bëhet në përputhje me sasinë e naftës së shpërndarë të përfituesit.

2.4 Trajnimi dhe transferimi i njohurive në fushën e bujqësisë

Mbështetje për trajnimin dhe transferimin e njohurive në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural nëpërmjet fermave model (ferma demonstrimi) nga Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), në vlerën deri në 30 041 000 (tridhjetë milionë e dyzet e një mijë) lekë.

Vlera e mësipërme do të përdoret nga UBT-ja në vitet 2023–2024 dhe përfaqëson pjesën e papërdorur të fondit të transferuar UBT-së, në zbatim të pikës 2.4, të vendimit nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2022”, të ndryshuar.

3. Për masat mbështetëse sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 2.1, të këtij vendimi, kur fondi në dispozicion rezulton më i vogël se totali i kërkesës së aplikimeve të bëra për masën përkatëse, vlera e financimit që përfitohet për njësi (krerë, zgjua apo ha), si dhe në total për subjekt, reduktohet në përputhje me këtë fond. Në rastet e shtesave/alokimeve eventuale të fondit, vlera e financimit që përfitohet nuk mund të jetë më e madhe se kufiri për masën përkatëse, i përcaktuar në këtë vendim.

4. Përfitues për masat e mbështetjes nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural janë fermerët, personat fizikë, personat juridikë, shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB), grupet vendore të veprimt (GVV) dhe UBT-ja.

5. Kriteret, procedurat dhe mënyra e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

6. Nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2023, do të përdoret shuma deri në 29 353 000 (njëzet e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë, për pagesën e vlerës së palikuiduar, për kontratat e parealizuar në masat e mbështetjes për investime në sektorin e peshkimit, për subjektet e shpallura fituese nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në zbatim të vendimit nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”, të ndryshuar.

7. Sasia prej 24 554 (njëzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e katër) litra e naftës së përfituar nga subjektet e shpallura fituese, për vitin 2022, në zbatim të vendimit nr. 101, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022”, të ndryshuar, e cila nuk u tërhoq brenda datës 31.12.2022, të tërhiqet deri në datën 30.6.2023.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



ANEKSI 1
KULTURA BUJQËSORE/GRUP-KULTURAT, NORMATIVAT E KONSUMIT TË NAFTËS DHE
SASIA E NAFTËS QË PËRFITOHET FALAS

Nr. kodi	Kultura bujqësore /grup-kulturash	Normativa e konsumit të naftës të punimeve të mekanizuara	Sasia e naftës që përfitohet falas*	Specifikime
		l/ha	l/ha	
A	Bimë arash			
A.1	Grupi 1	190	97	Pranverore (misër, fasule, luledielli, sojë, sorgum)
A.2	Grupi 2	130	66	Të lashta (grurë, tërshërë, thekër, elb), foragjere njëvjeçare, industriale (patate, duhan, panxhar, pambuk)
A.3	Grupi 3	90	46	Foragjere shumëvjeçare, bimë aromatike-mjekësore
B	Dru frutorë			
B.1	Mollë	190	97	
B.2	Dru frutorë të tjera	160	81	Të gjitha llojet e frutave, ulli, agrume dhe vreshta
B.3	Arrorë	140	71	Arra, bajame, lajthi dhe gështenja (të kultivuara)
B.4	Prodhim i fidanëve frutorë, agrume e arrorë	170	86	Për të gjithë fidanët e bimëve farore, bërthamore dhe arnore
C	Perime			
C.1	Perime fushe sezoni 1	150	76	Të gjitha llojet e perimeve përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe
C.2	Perime serre, sezoni 1	170	86	Të gjitha llojet e perimeve përfshirë shalqi, pjepër, luleshtrydhe

*** Nga çmimi i naftës, zbriten:**

- Akciza 37 lekë/l
- Taksa e qarkullimit 27 lekë/l
- Taksa e karbonit 3 lekë/l

Nën total 67 lekë/l

TVSH respektive (20%) 13,4 lekë/l

TOTAL 80,4 lekë/l

**** Koefficienti i përfitimit të naftës falas mbi normativë = $80,4 \text{ lekë} / 158,4^1 * 100 = 50,8\%$**

¹ Çmimi referencë për naftën për vitin 2023, është 158,4 lekë/Litër (pa TVSH)



VENDIM

Nr. 126, datë 2.3.2023

PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 12, të kapitullit VI, të Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare ditën e diel, datë 5.3.2023, në nderim të viktimave, si pasojë e aksidentit tragjik hekurudhor që ndodhi në Republikën e Greqisë, në datën 28.2.2023, ku humbën jetën një numër i madh qytetarësh të vendit fqinj, ndër të cilët edhe disa shqiptarë.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmështizë.

3. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore dhe publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë